



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 6 mars 2017, në mbledhjen e XXXVII - të (tridhjeteshtatë) të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13.05'.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Mehmet Gashi, kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Bahri Blakçori, Islam Revuçi, Fidan Rekaliu, Haki Rudari, Kadri Avdiu, Kumrie Hoti, Mynavere Abdullahau – Krasniqi, Naim Çunaku dhe Rafet Llapashtica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Ejup Visoka, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës, Kadastrit Gjeodezisë, Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agron Hyseni, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Muharrem Haziri, OSBE.

1.Miratimi i rendit të ditës

z. Rafet Llapashtica, theksoi, konsideroj se në këtë mbledhje do duhej të ishte në rend dite Raporti financiar për vitin 2016, këtë e them duke u bazuar se jemi në muajin mars që është afati i fundit për shqyrtimin e dokumentit të cekur.

Gjithashtu në këtë mbledhje do duhej të shqyrtoheshin edhe Raporti i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2016 dhe Plani i punës për vitin 2017 dhe Raporti i punës i Komitetit për Komunitete për vitin 2016 dhe Plani i punës për vitin 2017.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, thirrja e kësaj mbledhjeje është vonuar për shkak të përgatitjes së disa materialeve dhe jeni në dijeni se sipas planifikimit është mbledhje e muajit shkurt. Sa i përket Raportit financiar për vitin 2016 drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave më ka informuar se materiali është në përgatitje e sipër dhe i njëjti do të shqyrtohet në muajin mars që nënkupton se do të shqyrtohet në afatin e paraparë ligjor.

Rendi i propozuar i ditës u miratua me shumicë votash përkatësisht 9 vota për, asnjë kundër dhe 1 votë të përmbajtur.

2.Shqyrtimi i Ekstraktit të procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa më 1 shkurt 2017.

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri.

3. Propozimi i Vendimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2016 në vitin 2017 dhe destinimin në kategori të caktuara buxhetore.

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, Grupi i këshilltarëve i LDK – së e mbështet propozimin për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2016 në vitin 2017, arsyeshmërinë për bartje dhe destinim në projekte të caktuara në mënyrë mjaftë të mirë, në fjalën hyrëse, e paraqiti drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, i mbështesë disa prej propozimeve siç janë: ndërtimi i Zyrës së Vendit në Lluzhan dhe ndërtimi i objektit të shkollës në fshatin Llapashticë, konsideroj se këto projekte janë të qëlluara por gjithsesi më duhet të them se realizimi i tyre është i vonuar.

Lidhur me propozimin e këtij vendimi më gjerësisht do të diskutoj në mbledhjen e Kuvendit.

z. Haki Rudari, theksoi, të diskutojmë për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2016 në vitin 2017 në shumë prej 781.565,69 € e të mos e kemi të ditur se sa janë realizuar të hyrat vetanake është kontraverze, pra fillimisht duhet ta dimë shumën e arkëtuar të të hyrave vetanake e pastaj në mënyrë që të kemi të dhënat për realizimin apo mosrealizimin e planifikimit për të hyrat vetanake në vitin 2016.

Sikur ta kishim pasë Raportin financiar për vitin 2016 çështjet do t'i kishim më të lehta dhe më të qarta, kur e them këtë po ndërlidhem me atë që e tha drejtori në fjalën hyrëse se ne kemi pasë obligime financiare, nga kjo është e paqartë se mjetet e propozuara në kodet përkatëse a kanë të bëjnë me shlyerjen e obligimeve apo janë kode për projekte të reja.

Sa i përket kodit për ndërtimin e shkollës në fshatin Llapashticë ky projekt është dashtë kaherë të kryhet, por sigurisht ndërlidhet me vitin e fushatës para zgjedhjeve lokale mirëpo pavarësisht nga kjo është një projekt i mirë ngase objekti aktual është në gjendje të mjerueshme.

Sa i përket Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në bazë të disa bisedave jam në dijeni se bujqit i kanë pasë disa vërejtje, megjithatë do të ishte mirë që drejtori i Drejtorisë së cekur të na jep sqarime konkrete.

Te Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit nuk specifikohet ku do të kryhen punimet por vetëm thuhet, ndërtimi i trotuareve afër shkollave, meremetimi i rrugëve me zhavorr etj.

z. Kadri Avdiu, theksoi, krejtësisht është në rregull që mjetet e pashpenzuara nga të hyrat nga të hyrat vetanake të barten në vitin vijues mirëpo duhet pasë kujdes që ato mjete të destinohen në projekte më të rëndësishme.

Jam në dijeni se vitin e kaluar është destinuar një shumë e konsiderueshme në bujqësi, por disa mjete nuk janë realizuar gjatë gjithë vitit 2016 për shkak se në tender nuk është paraqit asnjë ofertues për shkak se fidanët e mjedrës kanë pasë një sëmundje.

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, theksoi, në programin e punës së Kuvendit është paraparë që në muajin shkurt të shqyrtohet bartja e të hyrave vetanake të pashpenzuara nga viti paraprak në vitin aktual, ndërsa sa i përket Raportit financiar për vitin 2016 sipas dispozitave ligjore është që i njëjti mund të shqyrtohet deri më 31 mars 2017.

Sa i përket mjeteve të propozuara për destinim në projektet përkatëse, nuk janë projekte të reja por janë projekte prioritare të vitit 2016 për të cilat kanë mbetur obligime financiare

dhe në vazhdim me të dhëna konkrete, për të gjitha projektet, sqaroi për shumat e planifikuara të projekteve dhe obligimet e pashlyera.

z. Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, theksoi, tri projektet që i përkasin lëmit të shërbimeve publike janë projekte të kontraktuara dyvjeçare, pra nuk kanë të bëjnë me mungesë të mjeteve por me vazhdim të realizimit të tyre.

Sa i përket se cilat rrugë do të shtrohen me zhavorr në këtë vit, mund të them se janë shumë rrugë e ndër më të rëndësishmet sipas kontratës janë: rruga e Rakinicës në gjatësi afro 2.800 m., lagjja e Cubollëve në mes të Gllamnikut e Kunushecit, te disa varreza, në Godishnjak – lagjja e Berishëve, Tërnavë – lagjja Zhinopotoku etj.

E njëjta situatë është edhe me ndërtimin e trotuareve, punime të cilat në kontratë janë të precizuara në mënyrë konkrete dhe atë duke filluar në Shajkoc afër shkollës në gjatësi 950 m., Metehi, Lladoc, Batlavë në dy vazhdimet (drejtime), në Podujevë rruga e magjistrales afër restaurantit “ Iliria “ etj.

z. Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, theksoi, gjatë vitit 2016 ne e kemi përgatitur dhe e kemi dërguar në Zyrën e Prokurimit kërkesën për publikimin e tenderit për fidanë të mjedrës, në dy rastet ka konkuruar e njëjta kompani e cila nuk i ka plotësuar kushtet e parapara. Përndryshe kërkesën e kemi bërë edhe në gjuhën angleze në mënyrë që t’iu jepet qasje edhe kompanive të huaja me qëllim që të sigurohen sa më cilësore fidanët e mjedrës.

Sipas kërkesës tonë përkatësisht tenderit një prej kushteve ka qenë që para ngarkesës së fidanëve të mjedrës një grup i ekspertëve të verifikojnë cilësinë e fidanëve në mënyrë që të mos paraqiten probleme të natyrës së sëmurjeve të ndryshme.

Ne shprehim keqardhje për këtë ngase kemi pasë një numër të madh të aplikuesve dhe nuk kemi mundur t’i përzgjedhim përfutuesit, mirëpo mjetet e destinuar për këtë qëllim barten në këtë vit, kur edhe besojmë se do të realizohet.

Jemi në konsultim me Zyrën ligjore që nëse nuk ka sukses përmes formës së tenderimit me të cilën po kemi probleme, të shqyrtohen mundësit për gjetjen e një forme tjetër ligjore për subvencionim ashtu si në mënyrën që e bënë ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Sa i përket çështjes të cilën e shtroi z. Haki Rudari, për disa ankesa të bujqve, edhe pse nuk e konkretizoi se për çfarë ankesash bëhet fjalë, kjo ka të bëjë me një numër të vogël të fermerëve të cilët komuna i ka subvencionuar në bazë të kontratës sipas së cilës fermerët e kanë pasë të drejtën e zgjedhjes që kudo t’i blejnë fidanët por duke i respektuar kriteret kontraktuale, fermerët e kanë zgjedhur kompaninë të njohur për të gjithë ne, fidanët kanë qenë me smurje, andaj fermerët nuk kanë probleme me Komunën por me kompaninë përkatëse me të cilën janë në proces gjyqësor.

Pas votimit u konstatua se propozimi i këtij vendimi njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

4.Propozimi i Vendimit për mbështetje financiare OJQ – në HANDIKOS – Qendra e rehabilitimit të bazuar në bashkësi

z. Agron Hyseni, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Fidan Rekalju, theksoi, drejtori z. Agron Hyseni, në mënyrë të qartë e arsyetoi propozimin e këtij vendimi andaj ne Grupi i këshilltarëve i LDK – së e mbështet këtë propozim ashtu si deri më tash duke u bazuar edhe në faktin se nga kjo Drejtori gjithëherë propozimet përkatësisht materialet kanë ardhur të rëndësishme dhe përgatitura mirë.

Në rastin konkret kemi të bëjmë me një kategori mjaftë të ndjeshme të qytetarëve, kategori të cilën e kemi mbështet edhe më parë dhe do ta mbështesin në vijimësi pa rezervë.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, Grupi i këshilltarëve i PDK – së e mbështet propozimin e këtij vendimi mirëpo është i mendimit se shuma e propozuar e mjeteve financiare është e pamjaftueshme për trajtimin vjetor të 900 personave që i përkasin kësaj kategorie.

Shtrohet pyetja se OJQ “ Handikos “ a i trajton edhe personat me sendorin dawn, në parim nuk është mirë që një kategori të mbështetet e tjetra jo, andaj jam i mendimit se Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale është dashtë të mbaj një takim me kryetarët e të gjitha organizatave të personave me nevoja të veçanta me qëllim të informimit të drejtpërdrejtë për nevojat e tyre dhe në bazë të kësaj Kuvendit t'i paraqet propozimin konkret për mbështetje në mënyrë proporcionale.

xxxxx

z. Kadri Avdiu, theksoi, OJQ “ Handikos “ në mënyrë të planifikuar dhe të qartë i ka paraqitur shpenzimet më elementare vjetore dhe në bazë të kësaj ka kërkuar mbështetje financiare e cila sipas mendimit tim duhet të miratohet pa kurrfarë hezitimi.

Mua më brengos fakti që përmendet në material se duhet të vizitohen edhe 55 raste të reja të personave me nevoja të veçanta.

z. Haki Rudari, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve i LVV – së dy – tri vitet e fundit e kemi vizituar OJQ – në “ Handikos “ dhe kemi biseduar me menaxherin dhe udhëheqësit tjerë dhe duke u bazuar në gjendjen e kësaj kategorie të qytetarëve jemi të mendimit se për nevojat e tyre nuk mjafton vetëm shuma e propozuar e mjeteve financiare ngase ata kanë edhe kërkesa të tjera.

Një numër i personave të kësaj kategorie janë me diploma të ndryshme ose në shkollim e sipër, andaj Ekzekutivi i Komunës duhet të shqyrtoj mundësitë për punësimin e tyre.

z. Kumrie Hoti, theksoi, jam e mendimit se shuma e propozuar për kategorinë e personave me nevoja të veçanta as që duhet të diskutohet, pra të mbështetet, mirëpo mua në kuadër të vizitave më shqetëson numri i 55 rasteve të reja dhe 39 personave me decubit që është numër i madh, andaj jam e interesuar të di se “ Handikos “ a ka mbikëqyrje për këta pacient, pra a trajtohen në mënyrë profesionale.

z. Agron Hyseni, theksoi, lidhur me çështjen e shtruar nga z. Rafet Llapashtica se duhet mbështetur të gjitha organizatat e personave me nevoja të veçanta, lidhur me këtë mund të them se nëse nuk është mbështetur një organizatë konkrete, nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale janë mbështetur në mënyrë individuale anëtarët e atyre organizatave dhe atë nga subvencionet apo ndonjë donacion.

Sa i përket shumë sipas propozimit të këtij vendimi që në krahasim me vitin e 2016 është shumë më e madhe ngase vitin e kaluar kanë kërkuar mjete vetëm për 9 muaj, ndërsa në këtë vit kanë kërkuar mjete për shërbime 11 mujore.

Përndryshe shuma e propozuar e mjeteve buxhetore është shumë vetë sa për të mbijetuar kjo OJQ, ngase kërkesat e personave të kësaj kategorie që janë rreth 900 anëtarë janë të mëdha, mirëpo duhet pasë parasysh se ka persona të kësaj kategorie që

ende nuk janë identifikuar e një prej arsyeve të kësaj është se familja për arsye të ndryshme nuk e lajmëron.

Shumica e anëtarëve të kësaj OJQ – je marrin trajtime mjekësore ditore, javore apo sipas nevojës.

Kjo OJQ në vazhdimësi, në fund të vitit, paraqet Raportin financiar i cili i nënshtrohet auditimit të jashtëm dhe në këtë drejtim është vlerësuar se e njëjta në nivel të komunave Kosovës më së miri i ka menaxhuar mjetet financiare, pra nuk ka pasë asnjë vërejtje.

Sa i përket vizitave mjekësore “ Handikos “ kujdeset dhe sipas nevojës anëtarët i sjellin në QMF apo QKMF për ofrimin e shërbimeve mjekësore përkatëse.

OJQ “ Handikos “ ndihmohet edhe nga donacione të ndryshme, në këtë kontekst ju informoj se nuk ka asnjë anëtar që ka nevojë për karroca apo ndonjë pajisje tjetër që nuk është pajisur me atë mjet e kemi raste që karrocata iu janë ndërruar.

Pas votimit u konstatua se Kuvendit, njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.

5. Informatë për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, dhe -Plani i punës i KKSB – së për vitin 2017

z. Faik Muçiqi, koordinator i KKSB – së, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Fidan Rekalu, theksoi, në fjalën hyrëse z. Faik Muçiqi, i përmendi aktivitetet dhe Planin e punës të KKSB – së, duke u bazuar se edhe unë më parë kam qenë anëtar i këtij Këshilli konsideroj se i njëjti ka rëndësi të veçantë, këtë e them ngase në përbërje të tij janë përfaqësuesit e të gjithë faktorëve që ndërlidhen me rendin dhe sigurinë në Komunën e Podujevës.

Në aspektin e luftës kundër ekstremizmit fetar përkatësisht rrymave radikale, Komuna e Podujevës ka qenë shembull në nivel të Kosovës.

Jam i mendimit se ky Këshill, duhet të mbështetet në mënyrë që të vazhdojë me punën e mirë që e ka bërë deri më tani, kur e them këtë ne asnjëherë nuk duhet të krijojmë kënaqësi për punën të cilën jemi duke e bërë, mirëpo për momentin është një punë e kënaqshme në raport me të gjitha komunat e Kosovës, pra në këtë drejtim Podujeva është simbol.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, në cilësinë e qytetarit gjatë bisedave të lira në cilësinë e qytetarit me zyrtar policor jam informuar se në Komunën e Podujevës është numër i vogël i zyrtarëve policor krahasuar me parametrat ligjor dhe me numrin aktual nuk mund të mbulohet i gjithë territori i Komunës. Lidhur me këtë Komandanti i Stacionit të Policisë së bashku me Kryetarin e Komunës duhet t'i drejtohen me kërkesë nivelit qendror për rritjen e numrit të zyrtarëve policor.

Sa i përket radikalizmit fetar, në radhë të parë qytetarët tanë janë treguar shumë të matur dhe është vështirë të gjenden fjalë për ta përshkruar këtë maturi.

Mos zbulimi i autorëve të vrasjes në Dumosh është shqetësuese jo vetëm për institucionin përkatës por për të gjithë ne.

Po ashtu lidhur me numrin e aksidenteve në trafik nuk jemi të kënaqur, pra situata në këtë drejtim nuk është për tu lavdëruar qoftë për shkak të mungesës së shenjzimeve apo sinjalizimeve qoftë për shkak të moskujdesit të qytetarëve apo mbikëqyrjes nga ana e shërbimeve përkatëse policore.

z. Haki Rudari, theksoi, sipas dispozitave ligjore parashihet që KKSB t'i raportoi Kuvendit të Komunës dy herë në vit, një herë në gjashtëmujorin e parë dhe një herë në gjashtëmujorin e dytë, pra ky obligim ligjor duhet të përmbushet.

Në këtë material janë disa informata të cilat KKSB i ka por ne si këshilltarë të Kuvendit nuk i kemi.

Do duhej të kemi informacione më të plota për vendosjen e kamerave në qytet, që sipas mendimit tim është ide shumë e mirë.

Gjithashtu do duhej të kemi informacione më të plota se si do të zgjidhet problematike e geneve endacak, problematikë mjaftë e madhe ngase edhe në oborre të shkollave ka qenë endacak.

Sa i përket gjendjes së pyjeve, unë me qëllim abstenova me rastin e miratimit të rendit të ditës ngase ka kohë që kam kërkuar një Informatë për gjendjen e pyjeve duke u bazuar se ka prerje të shumta ilegale të pyjeve dhe kam menduar se në këtë mbledhje do ta kemi Informatën e cekur, mirëpo kjo nuk ka ndodhur. Pyjet dëmtohen në sy të qytetarëve dhe të Ekzekutivit e ne heshtim dhe i mbyllim sytë.

Informatë për sigurinë në shkolla, për këtë ne këshilltarët e Kuvendit të Komunës nuk i kemi informacionet e plota, kur dihet se ka probleme në oborret e shkollave.

Në komunat tjera të Kosovës Komandanti i Stacionit të Policisë rregullisht raporton për gjendjen e sigurisë, ndërsa në komunën tonë pas katër viteve është hera e parë që do të raportoj në Kuvend.

Në faqen e dytë të Informatës thuhet se Stacioni i Policisë në Podujevë në bazë të vlerësimeve nuk ka personel të mjaftueshëm, pra vet e pranojnë se nuk ka personel të mjaftueshëm, përveç kësaj stafi ka qenë i angazhuar për punë dhe detyra jashtë territorit të Komunës, koj sipas mendimit tim është një element që duhet të debatohet.

Rasti i vrasjes në Dumosh ka krijuar pasiguri tek qytetarët, andaj përse të mps informohemi në detaje për këtë rast.

z. Kadri Avdiu, theksoi, në Informatën e KKSB – së janë përmbledhur çështjet kryesore të punës dhe angazhimit të këtij Këshilli, mirëpo për mua është shqetësuese çështja e zjarreve në pyje dhe si pasojë janë shkaktuar dëme të mëdha si në pyjet shtetërore ashtu edhe në pyjet private. Për këtë nuk jam i informuar se organet e ndjekjes e kanë filluar procedurën ndaj ndonjë autori të shkaktimit të zjarreve, ngase zjarret shkaktohen me qëllim, andaj kjo nuk mund të evitohet nëse ndaj shkaktarëve nuk shqiptohen sanksionet. Lidhur me këtë mund të jetë edhe çështja e mungesës të stafit të nevojshëm të policisë, që e përmendi parafolësi, mirëpo shtimi i numrit të zyrtarëve të policisë nuk varet as nga Komandanti i Stacionit të policisë e as nga kryetari i Komunës, por varet nga niveli qendror.

z. Faik Muçiqi, theksoi, kërkesa e shtruar që në Kuvend të Komunës të raportoi Komandanti i policisë, është kërkesë e qëlluar dhe mund të realizohet dhe se raporti i cekur mund të paraqitet për periudhë gjashtëmujore ose vjetore.

Në mbledhje të KKSB – së është pikë e veçantë e rendit të ditës çështja e sigurisë së përgjithshme për të cilën raportojnë Policia dhe KFOR – i.

Gjatë vitit për të cilin është paraqitur informata janë shqyrtuar çështje më të shumta se që janë paraqitur në këtë material dhe një ndër temat që është debatuar ka qenë edhe mungesa e stafit policor në raport me numrin e banorëve dhe madhësinë e territorit. Lidhur me këtë, sigurisht e keni vërejtur se KKSB – ja me shkresë i është drejtuar Zyrës Regionale të Policisë për me shtuar numrin e zyrtarëve policor. Ndërsa sa i përket

çështjes së pjesëmarrjes të zyrtarëve policor të stacionit të policisë në komuna të tjera, kjo ka qenë gjatë periudhës së protestave në Prishtinë dhe është normale që policia e regjioneve të njëjta të bashkëpunojnë në mes veti.

z. Haki Rudari, theksoi, sipas dispozitave ligjore është paraparë që brenda një viti fiskal të kemi dy informata të KKSB – së, andaj kjo duhet të respektohet.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, gjatë debatit u përmend kërkesa e shtruar më herët për paraqitjen e Informatës për gjendjen e pyjeve dhe shtoi, për këtë çështje, por edhe për bujqësinë në përgjithësi, kam biseduar me drejtorin e Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe më ka premtuar se do ta përgatitë atë informatë.

Gjithashtu, gjatë debatit, u shtrua kërkesa që në mbledhje të Kuvendit të raportoi Komandanti i Stacionit të policisë për gjendjen e sigurisë në Komunë, lidhur me këtë do të bisedoj me Komandantin dhe besoj se kjo kërkesë do të përmbushet.

Pas votimit u konstatua se informata dhe Plani i punës i KKSB – së Kuvendit, njëzëri i rekomandohen për shqyrtim.

6. Propozimi i vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës dhe pronës publike rrugë – lokale në shfrytëzim afatgjatë Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike – KEDS

z. Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës, Kadastrit dhe gjeodezisë, e paraqiti fjalën Hyrëse.

Nuk pati diskutime dhe pas votimit u konstatua se Kuvendit, njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.

7. Ndryshimi i përbërjes së Komitetit për Komunitete.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, e paraqiti fjalën hyrëse.

Pas votimit u konstatua se Kuvendit, njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.

Mbledhja përfundoi në orën 14.10’.

**Procesverbalin e mbajti
Faik Gashi**

**Nr. 01- 060/04-16673/17
Podujevë,
6 mars 2017**

**Kryesuesi i Komitetit
Mehmet Gashi**